



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:093328

Datë: 02.05.2024

Numri i dokumentit: 05645954

**PKR.nr.674/2012**

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA**, në përbërje nga trupi gjykues prej tre gjyqtarëve profesionistë, përkatësisht gjyqtari Naser Foniqi – kryetar i trupit gjykues dhe Fatime Dërmaku e Ertan Sejfulla - anëtarë të trupit gjykues, me bashkëpunëtoren profesionale Arbenita Hoxha Koleci, në çështjen penale të akuzuarve H.Y., i akuzuar për shkak të veprës penale Pastrimi i parave, nga neni 10, par. 10.2, pika a, b dhe d, të rregullores së UNMIK numër 2004/2, mbi pengimin e pastrimit të parave dhe veprave të ngjashme penale dhe Sh.R., i akuzuar për shkak të veprës penale Pastrimi i parave, nga neni 10, par. 10.2, pika a, b dhe d, të Rregullores së UNMIK numër 2004/2, mbi pengimin e pastrimit të parave dhe veprave të ngjashme penale, në ndihmë nga neni 25 të KPK, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PP.nr.349-6/2007, të datës 11.02.2008, pas shqyrtimit gjyqësor, të hapur për publikun, të mbajtur më datat 12.10.2023, 15.01.2024 dhe 22.04.2024, në të cilin kanë qenë të pranishëm: prokurorët special Merita Bina Rugova e Burim Çerkini dhe të akuzuarit H.Y. me mbrojtësin e tij av. Ali Beka me autorizim dhe Sh.R., me mbrojtësin e tij av. Abdylaziz Sadiku, me autorizim, si dhe përkthyesja e gjykatës B.K., pas shqyrtimit gjyqësor, me datë 22.04.2024, mori dhe publikisht, shpalli këtë:

## A K T G J Y K I M

### Të akuzuarit:

**H.Y.**, i biri i H. dhe Y., e vajzërisë Y., i lindur me datë ..., në S.../Turqi, me banim të përkohshëm në ..., lagja ..., rruga ..., numër ..., me numër telefoni ..., me numër personal ..., i martuar- baba i katër fëmijëve, ka të kryer gjimnazin, i punësuar realizon të hyra mujore rreth 1200 euro - i gjendjes së mesme ekonomike, turk - shtetas i Republikës së Turqisë, **ka qenë nën masën e paraburgimit prej datës 18.05.2007 deri me datë 15.01.2009** dhe

**Sh.R.**, i biri i R. dhe H., e vajzërisë Z., i lindur me datë ..., në fshatin M., Komuna Viti, me numër personal ..., i martuar- baba i katër fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar realizon të hyra mujore rreth 1500 euro- i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës.

Konform nenit 363, par. 1, nënpar. 1.3, të Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale,

## LIROHEN NGA AKUZA

**S e p s e:** me datë 22.12.2005, i akuzuari H.Y. e ka hapur llogarinë rrjedhëse dhe i ka deponuar 9.884,95 dollar amerikan, ndërsa ditën e nesërme nga kjo llogari e tij ka tërhequr shumën prej 99.000 dollar të cilat ia ka dhënë të akuzuarit Sh.R. që ai ti deponojë në llogarinë rrjedhëse në emër të firmës “E...” në Procredit Bank dhe të njëjtën shumë parash të njëjtën ditë i akuzuari Sh.R. nga llogaria e “E...” e ka transferuar në kompaninë “C...” në E., para këto të cilat ishin të fituara në mënyrë të kundërligjshme nga mashtrimet e bëra qytetarëve të cilët kanë luajtur lojën e fatit dhe nga paratë të cilat ishin nga shmangia e tatimit nga firmat “K...” dhe “K1...” krejt kjo e bërë me qëllim të pastrimit të parave të cilat janë fituar nga vepra penale mashtrimi dhe shmangia e tatimit me qëllim të shfrytëzimit të tyre,-

- pasi që, nuk është provuar se i akuzuari H.Y. ka kryer veprën penale Pastrimi i parave, nga neni 10, par. 10.2, pika a, b dhe d, të rregullores së UNMIK numër 2004/2, mbi pengimin e pastrimit të parave dhe veprave të ngjashme penale, dhe
- pasi që, nuk është provuar se i akuzuari Sh.R. ka kryer veprën penale Pastrimi i parave, nga neni 10, par. 10.2, pika a, b dhe d, të Rregullores së UNMIK numër 2004/2, mbi pengimin e pastrimit të parave dhe veprave të ngjashme penale, në ndihmë nga neni 25 të KPK.
- Shpenzimet gjyqësore, bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

## ARSYETIMI

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, me aktakuzën PP.nr.349-6/2007, të datës 11.02.2008, ka akuzuar të pandehurit H.Y., i akuzuar për shkak të veprës penale Pastrimi i parave, nga neni 10, par. 10.2, pika a, b dhe d, të Rregullores së UNMIK numër 2004/2, mbi pengimin e pastrimit të parave dhe veprave të ngjashme penale dhe Sh.R., i akuzuar për shkak të veprës penale Pastrimi i parave, nga neni 10, par. 10.2, pika a, b dhe d, të Rregullores së UNMIK numër 2004/2, mbi pengimin e pastrimit të parave dhe veprave të ngjashme penale, në ndihmë nga neni 25 të KPK.

Këtë çështje penale e ka kthyer në rivendosje Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin AP.nr.158/2009, të datës 23.05.2012, sa i përket pikës I/3, të aktgjykimit P.nr.122/08, të datës 12.01.2009, për të akuzuarit si më lart me arsyetim se dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar në pikën 1.3 është i pa qartë, pasi sipas tij përshkruhen tiparet e veprës penale pastrimi i parave ku theksohet se i akuzuari H.Y. ka kryer veprën penale Pastrimi i parave, nga neni 10, par. 10.2, pika a, b dhe d, të rregullores së UNMIK numër 2004/2, mbi pengimin e pastrimit të parave dhe veprave të ngjashme penale, ndërsa i akuzuari Sh.R. ka kryer veprën penale Pastrimi i parave, nga neni 10, par. 10.2, pika a, b dhe d, të Rregullores së UNMIK numër 2004/2, mbi pengimin e pastrimit të parave dhe veprave të ngjashme penale, në ndihmë nga neni 25 të KPK, duke shtuar se nga shkresat e lëndës nuk është kontestuese se transferimi i parave në shumë prej 99.000 \$ është bërë pa ndonjë dokument përkatës, nuk është kontestues edhe fakti se të akuzuarit pasi është iniciuar procedura penale ndaj tyre i kanë paguar të gjitha obligimet tatimore në shumë prej 1.145.781,38 euro, por dispozitivin e aktgjykimit e bën të paqartë fakti se në të nuk saktësohen cilat nga forma e mundshme të veprës penale nga neni 10.2 të rregullores si më lart e kanë konsumuar të akuzuarit, por vetëm thuhet se kanë kryer veprën penale nga pikat a, b dhe d, dmth., nuk është e qartë se a i kanë konsumuar këto tri forma të mundshme apo vetëm njërën nga ato dhe në këtë drejtim nuk ka arsyetim, gjë që dispozitivin e bën të paqartë dhe pamundëson vlerësimin e aplikimit të drejtë të ligjit në këtë pjesë. Po ashtu, gjykata e instancës më të lartë ka thënë se nuk janë dhënë sqarime të qarta për rolin e të akuzuarit Sh.R. se si i ndihmoj të akuzuarit H. në pastrimin e parave, dmth., a ishte në dijeni për prejardhjen e këtyre

parave dhe a ishte koshient se po e ndihmon të akuzuarin H., e për këtë gjykata nuk ka dhënë arsye të qarta. Gjykata supreme ka sugjeruar që në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në pajtim me vërejtjet e theksuara më lart dhe pas procedimit dhe vlerësimit të provave për këtë pjesë të aktgjykimit të vërtetoj gjendjen faktike dhe këto veprime t'i vejë qartë nën normën përkatëse juridike pastaj të përcaktoj qartë rolin e të akuzuarit Sh.R. në këtë çështje penale juridike, se veprimet që i kishte marrë ai i kishte ndërmarrë për shkak të raporteve afariste që ekzistonin mes tyre, apo për ta ndihmuar në pastrimin e parave të akuzuarin H. e më pas të marr një vendim të drejtë në këtë çështje penale juridike.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 12.10.2023, pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, të akuzuarit H.Y. dhe Sh.R., kanë deklaruar se e kanë kuptuar aktakuzën dhe janë deklaruar të pafajshëm për veprat penale për të cilat janë akuzuar.

Në fjalën hyrëse prokurori special ka deklaruar se kjo çështje penale është pjesë e rastit voluminoz i cili ka përfunduar me nxjerrjen e aktgjykimit fajësues, e ku mes të dënuarve të tjerë është edhe i akuzuari H.Y., duke shtuar se me provat e këtij rasti si dhe me aktgjykimin e shkallës së parë dhe shkallës së dytë në mënyrë të pa kontestueshme është vërtetuar se subjekti afarist K1... dhe K... ku i akuzuari H.Y. ka qenë arkëtar, në mënyrë të vazhdueshme ka kryer mashtrime dhe shmangia nga tatimi, e për këtë ekzistojnë dëshmi, ndërsa shumat janë milionëshe, për të gjitha elementet esenciale të veprës penale Pastrimi i parave, përkatësisht kundër të akuzuarve në sallë ekzistojnë provat materiale me besueshmëri maksimale. Po ashtu, prokurori special ka thënë se ekspertit financiar R.B. ka konstatuar se për transfere të shumës 99.000 \$ amerikan të kryera me datë 22-23.12.2005 nuk ka gjetur asnjë dokument i cili do të justifikonte qëllimet e këtyre transferove, e gjithashtu transferi nuk është zyrtarizuar as në librat zyrtarë të biznesit E... e as nuk është arsyetuar me ndonjë veprim afarist, e të gjitha këto pretendime do të vërtetohen me administrimin e provave gjatë shqyrtimit kryesor dhe pa asnjë dëshmi do të vërtetohet ekzistimi i veprës penale për të cilën akuzohen të akuzuarit si dhe përgjegjësia e tyre penale.

Ndërsa në fjalën përfundimtare, prokurori special ka deklaruar se me datë 22-23 dhjetor 2005 të akuzuarit kanë kryer veprime tipike të veprës penale Shpëlarja e parasë për të cilën akuzohen, e këtë konkludim e vërtetojnë disa fakte, përkatësisht me datë 22.12.2005 i akuzuari H.Y. e ka hapur llogarinë bankare personale në P., e të njëjtën ditë ka bërë deponimin e shumës prej 99.000 dollarë, pra është e qartë se llogaria është hapur ekskluzivisht për këtë qëllim që të deponohet shuma e lartcekur, derisa të nesërmen me datë 23.12.2005 i akuzuari H. ka bërë tërheqjen por jo shumës në tërësi por në dy këste, pastaj shumën e tërësishme e ka transferuar në xhirollogari të firmës "E...", pastaj, i akuzuari Sh.R. të njëjtën ditë nga llogaria e firmës "E..." paratë i ka transferuar në llogarinë e C... në E. Po ashtu, prokurori special ka theksuar se i akuzuari H.Y. ka punuar si arkëtar në firmën "K...", e megjithatë nuk e ka asnjë informatë në lidhje me prejardhjen e këtyre parave, e as lëvizjen e pazakontë të atyre parave në disa llogari në një kohë aq të shkurtër, duke shtuar se njëjti është mbrojtur se ka vepruar sipas urdhrin të menaxherit të firmës "K...", mirëpo nuk ka ofruar asnjë shpjegim se pse e ka hapur xhirollogarinë personale në bankë pikërisht atë ditë, nuk ka shpjegim as për faktin se përse paratë i ka vendosur në llogarinë personale dhe pse ka bërë tërheqje në dy këste. Pastaj, prokurori special, ka theksuar se i akuzuari tjetër Sh.R., mbrojtjen e vet e ka përshtatur me mbrojtjen e të akuzuarit H. ashtu që ka pohuar si në vijim: "më ka thirr K. nga Elbasani dhe më ka thënë H. t'i sjell 99.000 dollarë dhe t'i do të mi sjellësh në Shqipëri", pa ia treguar arsyen, duke shtruar pyetjen "Pse H. nuk i deponon ato para direkt në llogarinë e K., cila mund të jetë arsyeja ligjore që të transferohet një shumë e madhe e parave në disa llogari kur dihet destinacioni i fundit?", sidoqoftë i akuzuar Sh.R. në deklaratën e datës 19.09.2007 në PSRK, ka pasur një mbrojtje tjetër: "këtë shumë unë më herët e kam lënë si dorëzani te H. pasi që kam ble hekur për këtë shumë ashtu që H. në këtë rast këtë shumë fillimisht e ka deponuar në xhirollogari të firmës sime E... dhe në emrin tim e

pastaj unë këtë shumë e kam transferuar në llogarinë e firmës K...”. Po ashtu, prokurori special ka thënë se mbrojtja e dy të akuzuarve është shumë e pa logjikshme, jo bindëse, në kundërshtim me të gjitha provat dhe mendon se duhet të refuzohet si e pabazuar, duke shtuar se pavarësisht nga metodat që përdoren për pastrimin e parave, ky proces kryhet në tri faza: vendosja apo ndarja fizike e të hollave, pastaj shtresimi- transferet dhe në fund integrimi apo blerja e aseteve të ndryshme, e ato faza mund të shfaqen si të ndara mirëpo gjithashtu mund të ndodhin edhe në të njëjtën kohë dukë mbuluar njëra tjetrën, por në esencë pastrimi i parave është lëvizja e kapitalit të fituar me kryerjen e veprave penale në sistemin legal financiar ndërsa qëllimi kryesor është që kapitali të futet në sistemin financiar pa u vërejtur origjina e tij, të mbahet në lëvizje në mënyrë që të bëhet sa më vështirë që të identifikohet burimi i tij origjinal dhe në fund të shfaqet në sistemin financiar si një mjet legjitim. Po ashtu, prokurori special ka theksuar se të akuzuarit i kanë kryer pikërisht këto veprime tipike për kryesit e veprës penale të shpëlarjes së parave, sepse brenda 24 orëve kanë bërë transferin e 99.000 dollarëve në tre xhirollogari të ndryshme bankare dhe për këto veprime nuk e kanë asnjë arsyetim të logjikshëm, dhe se eksperti financiar ka konstatuar se këto mjete nuk figurojnë në librat zyrtare të biznesit E... ashtu që asnjëherë nuk janë zyrtarizuar, por se i akuzuari H.Y. akuzohet se ka transferuar pasurinë me qëllim të fshehjes apo të maskimit të natyrës, burimit, vendit, distribucionit, lëvizjes ose pronësisë së pasurisë dhe me qëllim të ndihmës së personit i cili është i përfshirë në kryerjen e veprës penale, ndërsa përkrahimi i kësaj veprë penale si dhe dënimi i paraparë me ligj është identik edhe sot sipas ligjit në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave, andaj konsideron se me provat e administruara është dëshmuar se H.Y. e ka kryer këtë veprë ndërsa i akuzuari Sh.R. i ka ndihmuar në kryerjen e kësaj veprë penale, ashtu që ka kërkuar që të njëjtit të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit.

Në fjalën hyrëse mbrojtësi i të akuzuarit H.Y., av. Ali Beka ka deklaruar se meqenëse në çështjen penale barra e të provuarit bie mbi prokurorinë dhe nëse edhe ai si mbrojtje ofron prova ose pretendon për pafajësi, prapë se prapë prokuroria nuk lirohet nga barra e të provuarit të pretendimeve të aktakuzës gjithashtu në këtë çështje penale shumë saktë e ka thënë Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj se aktakuza përkatësisht me aktgjykimin e kthyer në rigjykim për veprën penale pastrimi i parave nuk është vërtetuar forma e veprës penale të caktuar me nenin 10 par 10.2 pika a, b dhe d, e për të cilën as atëherë e as tani prokuroi nuk do të arrijë ta vërtetoj se i pandehuri H. ka pasur qëllim apo dijeni lidhur me pastrimin e parave, përderisa i njëjti në K... ka qenë një punëtorë, përkatësisht arkëtar dhe për shmangie nga tatimi siç e tha prokurorja ajo kompani, shtetit ia ka kompensuar tatimet me mbi një milion euro, e me të cilën eventualisht edhe kjo shumë e pretenduar prej 99.000 \$ nuk paska qenë në librat kontabël si do që të jetë është paguar tatimi edhe për këtë shumë, ashtu që ka bindjen se në fund të shqyrtimit gjyqësor, në mungesë të provave gjykata do të merr aktgjykim lirues.

Ndërsa në fjalën përfundimtare, mbrojtësi i të akuzuarit H.Y., ka deklaruar se vepra penale Pastrimi/Shpëlarja e parave në esencë nënkupton qarkullimin e parave me prejardhje të paligjshme, si në aspektin teorik ashtu edhe në atë praktikë ka skemat e veta e që nënkupton veprimtarinë e paligjshme e cila në vete përfshinë prodhimin dhe trafikun e lëndëve narkotike dhe drogës, veprimtari të tjera të paligjshme si trafikun e armëve, klandestinëve, prostitucionit, toto futbollit, zhvatjen me dhunë të parave, etj., pastaj vënia në punë e tyre në forma të ndryshme, duke shtuar se edhe vepra penale e pastrimit të parave, sipas aktakuzës nuk mund të skematizohet në ndonjë formë të skemave që paraqitet qarkullimi i parave me prejardhje të paligjshme, për faktin se paratë sipas aktakuzës, janë të njohura si për nga burimi, qëllimi, destinimi i tyre e tjera, e që janë paguar në emër të shmangies nga tatimi shuma prej 1,145,781.38 euro, si dhe pretendimi se ato para janë fituar me veprë penale, në raport me të akuzuarin H. nuk qëndron për arsye se prokurori si në aktakuzë por edhe në fjalën e tij përfundimtare ka pretenduar se i akuzuari H.Y. me datë 22.12.2005 ka hapur llogarinë rrjedhëse dhe ka deponuar 99.884,95 dollarë amerikan, ndërsa nga kjo shumë, ditën e nesërme e ka tërhequr shumën prej 99,000.00

dollarë, të cilat ia ka dhënë të akuzuarit Sh.R. që ai t'i deponoj në llogarinë rrjedhëse të firmës "E..." e të njëjtat para i akuzuari Sh.R. nga llogaria e firmës së tij i ka transferuar në kompaninë "K..." në Elbasan e të cilat para ishin të fituara në mënyrë të kundërligjshme nga mashtrimet e bëra ndaj qytetarëve të cilët kishin luajtur lojën e fatit si dhe nga paratë e fituara nga shmangia e tatimit". Pastaj, mbrojtësi Beka ka thënë se H.Y. në Kosovë kishte ardhur diku në gjysmën e vitit 2004, për të punuar në "K1..." e për këtë kishte edhe një kontratë pune për punët dhe detyrat e punës si arkëtar, pra i punësuar në mënyrë të rregullt, me pagë mujore, asnjëherë më parë i gjykuar, rrjedh prej një familje të varfër, dhe në Kosovë nuk ka ardhur që të fitoj por për ekzistencë materiale, derisa punën e vet e ka kryer në kuadër të punëve të arkëtarit dhe urdhrave të menaxherit dhe vartësve të tij, duke theksuar se figura e veprës penale Pastrimi i parave, e sanksionuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/2, pasqyron edhe elementet e saj themelore të cilat përbëjnë figurën e veprës penale, e sipas rregullores, veprën penale Pastrimi i parave e kryen: Neni 10.2 kushdo që duke ditur ose që ka arsye për të ditur se pasuria e caktuar buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal, pasuri kjo e cila në të vërtetë fitohet me vepër penale ose kushdo që, duke besuar se pasuria e caktuar fitohet nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal bazuar në përfaqësimet e bëra si pjesë e një hetimi zbulues të zhvilluar në Pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/6 të datës 16 mars 2002 mbi masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit: a) Konverton a transferon ose përpiket të konvertoj a të transferoj pasurinë me qëllim të fshehjes apo maskimit të natyrës, burimit, vendit, dispozicionit, lëvizjes së pasurisë; b) Konverton, transferon ose përpiket të konvertoj a transferoj pasurinë me qëllim të ndihmës së personit i cili është i përfshirë në të ose që, siç pandehet, është përfshirë në kryerjen e veprës penale që ka shkaktuar Shmangien e pasojave ligjore a të pasojave të qarta ligjore të veprimit të tij; dhe d) Konverton, transferon ose përpiket të konvertoj a transferoj pasurinë me qëllim të nxitjes së aktivitetit të ndërlidhur kriminal.

Po ashtu, mbrojtësi Beka ka thënë se në këtë drejtim nuk mund të anashkalohet dhe mos të vihen në vëmendje edhe konstatimet e Gjykatës Supreme të Kosovës në aktgjykimin AP.nr.158/2009 të datës 23.05.2011 lidhur me këtë çështje penalo juridike, ku ... ndër tjera është konstatuar se sipas nenit 9 të Rregullores të UNMIK-ut nr. 2004/2 mbi pengimin e pastrimit të parave dhe veprave të ngjashme penale, mjetet të cilat e tejkalojnë shumën prej 10,000.00 Euro, detyrimisht duhet paraqitur me shkrim, shumën e mjeteve financiare dhe burimin e tyre për çka të akuzuarit në rastin konkret kanë vepruar në kundërshtim me dispozitën e nenit 9 të rregullores së përmendur, dhe sipas paragrafit 9.4 të nenit 9 të kësaj rregulloreje personi i tillë kryen veprim të kundërvajtjes, ndërsa nuk është kontestuese se transferimi i parave në shumë prej 99,000.00 USD është bërë pa ndonjë dokument përkatës, nuk është kontestuese edhe fakti se të akuzuarit pasi që janë zbuluar/iniciuar procedurë penale ndaj tyre/ i kanë paguar të gjitha obligimet tatimore në shumë prej 1,145,781.38 Euro, mirëpo nuk saktësohen se cilën nga format e mundshme të veprës penale nga neni 10.2 të rregullores për pengimin e pastrimit të parave e kanë konsumuar të akuzuarit por vetëm thuhet se kanë kryer vepër penale nga pika a, b, d, që d.m.th., se nuk është e qartë se i kanë konsumuar këto tri forma të mundshme apo vetëm një të një nga ato dhe në këtë drejtim nuk ka arsyetim, derisa nga përfundimet e Gjykatës Supreme të Kosovës, në rigjykim është kërkuar të vërtetohet cila formë e kësaj vepre penale pastrimi i parave është konsumuar në veprimet e të pandehurve, dhe nëse po a ka pasur dashje dhe qëllim të pastrimit të parave nga të pandehurit.

Pastaj, mbrojtësi Beka ka theksuar se në drejtim të konstatimeve të Gjykatës Supreme, duhet të kihet parasysh edhe fakti se në kohën kur ka vepruar H.Y. si në përshkrim të aktakuzës, ka qenë një kohë kur sistemi bankar dhe i pagesave nuk është konsoliduar në formën e mjaftueshme dhe se janë lejuar pagesa edhe në formën e tillë, siç e ka sqaruar eksperti financiar në ekspertizën nr.024/2008 të datës 24.12.2008, ku në mendimin dhe konstatimin e tij, të gjitha transaksionet që pretendon aktakuza i ka vlerësuar të rregullta, të cilat edhe i ka sqaruar në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 05.01.2009, e të gjitha këto argumente konsideron se janë

më shumë se një tregues se H.Y. ka vepruar konform urdhrit të K.Z., dhe i njëjti nuk ka pasur as ma të voglin dyshim se po vepron në kundërshtim me ligjin, e aq më pak me pastrim të parave, e ku i akuzuari H. në deklaratën e tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor ka thënë "Unë nuk kam pasur njohuri nëse deponimi i mjeteve prej 99,000.00 dollarë ka qenë i jashtëligjshëm apo i ligjshëm, për mua ishte njësoj sikur 100 dollarë kur i kam dhënë një punëtori avans për pagën, sikur 99,000.00 dollarë kur ia kam deponuar Sh. Po të kisha ditur se deponimi i 99,000.00 dollarëve Sh. ishte i kundërligjshëm nuk do ta kisha kryer atë, do të kisha lënë punën dhe do të isha larguar nga Kosova".

Në fund të fjalës së tij përfundimtare, mbrojtësi Beka ka thënë se nga vlerësimi i drejtë i provave të administruara në këtë çështje penale, konsideron se nuk është vërtetuar se H.Y., e ka kryer veprën penale siç pretendohet me aktakuzën, sepse provat e administruara në shqyrtim gjyqësor nuk kanë qenë të mjaftueshme për të mbështetur një gjykim të fajësisë sa i përket ekzistimit të veprës penale pastrimi i parave, duke shtuar se meqenëse, në këtë çështje penale, edhe mund të ketë mëdyshje lidhur me faktet vendimtare, se H.Y. a ka pasur qëllim dhe dashje për pastrimin e parave siç pretendon prokurori, mbrojtësi konsideron se konform dispozitës së nenit 3 KPPRK, mëdyshjet duhet të interpretohen në favor të të pandehurit e që korrespondon edhe me parimin in dubio pro reo, sepse siç është përcaktuar edhe me dispozitën e nenit 7 të KPPRK, gjykata, prokurori dhe policia në procedurë penale detyrohen që saktësisht dhe tërësisht të vërtetojnë faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, prandaj, duke u bazuar edhe në dispozitën e nenit 8 dhe 360 të KPP, se gjykata merr vendim në bazë të provave që shqyrtohen dhe verifikohen në shqyrtimin gjyqësor, dhe aktgjykimin gjykata e mbështet vetëm në provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, trupit gjykues i ka propozuar që në pajtim me nenin 363 par. 1 nënpar. 1.3 të KPP, H.Y. ta liroj nga akuza, sepse nuk është provuar se e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Në fjalën përfundimtare i akuzuari H.Y. ka deklaruar se e përkrahë fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, duke shtuar se në atë kohë ai ka qenë 24-25 vjeç dhe nuk ka pasur njohuri se po vepron kundërligjshëm dhe sipas mendimit të tij nuk ka vepruar kundërligjshëm, derisa me veprimet e tij për bartjen e mjeteve nuk ka përfituar asgjë përveç pagës së tij të rregullt, dhe se nuk e ka ditur se me veprimet e tij po shpërlante paratë, derisa kjo ka qenë hera e parë që nga K... ka deponuar para për kompaninë "K1..." e cila ka qenë pronare e K... dhe K...

Në fjalën hyrëse mbrojtësi i të akuzuarit Sh.R., av. Abdylaziz Sadiku ka deklaruar se tërësisht i akcepton fjalët e kolegut të tij Beka, duke shtuar se të gjitha provat në shkresat e lëndës nuk e dëshmojnë faktin se në rastin konkret kishte një dashje për kryerjen e kësaj vepre penale, e duke iu referuar aktgjykimit të Gjykatës Supreme, ai ka pritur që prokurorja ta bëjë një precizim të aktakuzës në drejtim të pandehurve por kjo mund të ndodhë në fjalën përfundimtare, duke theksuar se Gjykata Supreme ka sugjeruar që në këtë çështje të vërtetohet se mos eventualisht ekzistojnë elementet e veprës penale nga neni 9 i rregullores për shpëlarjen e parasë sipas të cilës dispozitë paragrafi 9.4 e paraqet si procedurë të kundërvajtjes.

Ndërsa në fjalën përfundimtare, mbrojtësi i të akuzuarit Sh.R. ka deklaruar se cilësimi juridik i veprës penale ndaj të pandehurit Sh.R. është shumë i përgjithësuar respektivisht jo i konkretizuar apo jo kompatibil me veprimet e tij përkatësisht nuk është e qartë se i pandehuri me veprimet e veta a i ka konsumuar tri format e mundshme të veprës penale apo vetëm njërin nga ato sepse në këtë drejtim edhe Gjykata Supreme me aktvendimin AP.nr.158/2009 e datës 23.05.2013 kishte bërë vërejtje që në riprocedurë duhej të vërtetohej se cilën nga format e veprës penale të nenit 10 të Rregullores për Pastrimin e parave e ka konsumuar i akuzuari ndonëse nuk mundet të nxjerrët konkludimi se i ka kryer me një veprim tri format e saj. Pastaj ka shtuar se për të ekzistuar si e kryer vepra penale e cila i vihet në barrë të mbrojturit të tij duhet të përmbushen disa parakushte ndër to që kryerësi i veprës ta ketë ditur dhe besuar nga ndonjë

hetim zbulues se pasuria e caktuar buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal, që këto para që burojnë nga aktiviteti kriminal ti transferoj me qëllim të fshehjes apo maskimit të natyrës së burimit të parave dhe vendit prej nga vijnë ato para dhe transferimi i këtyre mjeteve e bën me qëllim të nxitjes së aktivitetit të ndërlikuar kriminal që do të thotë se kryerësi i veprës penale në ndihmë në këtë rast i pandehuri Sh. domosdo duhet ta dinte paraprakisht se paratë të cilat ishin objekt i akuzës të rrjedhnin nga ndonjë aktivitet kriminal dhe se ky transferim i parave të bëhej me qëllim të nxitjes së ndonjë aktiviteti kriminal. Pastaj, mbrojtja ka thënë se i pandehuri as atëherë e as tani nuk kishte ndonjë provë apo informacion që kompania “C...” nga Elbasani - Republika e Shqipërisë me subjektet e saj juridike “S...”, “K1...”, “K...”, që vepronin në Kosovë merreshin me aktivitet kriminal duke theksuar se as shërbimi bankar me rastin e deponimit të parave nuk kishte kërkuar provë për origjinën e këtyre parave për pengimin e këtij qarkullimi - transferimi të parave sikur të dyshonte se paratë buronin nga ndonjë aktivitet kriminal i ndaluar me ligj. Po ashtu i pandehuri Sh.R. ka sqaruar se punon si përgjegjës apo menaxher i depos në Ferizaj në kuadër të subjektit afarist “E...” me seli në Viti dhe se veprimtari e këtij biznesi janë importet edhe eksportet e mallrave si dhe shitja me shumicë – pakicë e materialit ndërtimor, që do të thotë edhe furnizimin dhe shitjen e hekurit si strukturë e materialit ndërtimor. Në atë kohë “E...” kishte filluar të punoj me shkritoren e hekurit në Elbasan ashtu që mbeturinat e metalta qofshin ato edhe hedhurinë për bri rrugëve ose në natyrë apo të deponuara në depo të ndryshme në Kosovë i merrte dhe i eksportonte për shkritoren e Elbasanit dhe si kundërvlerë merrte hekurin për ndërtim. Pastaj, në ndërkohë fabrika e Elbasanit kishte kërkesa të mëdha për hekur dhe kërkonte që hekuri në fazën e porosisë të paguhej paraprakisht ashtu që paratë për sasinë e hekurit të porositur të lihen si dorëzani të personi i caktuar, e në këtë rast personi i caktuar nga menaxheri i fabrikës në Elbasan ishte H.Y. nga Turqia. Ndërsa, i pandehuri Sh. në interes të afarizmit duhet ti respektonte këto kërkesa të Elbasanit. Pastaj, mbrojtësi i të pandehurit Sh. ka përshtuar ngjarjen e ditës kritike duke theksuar se i pandehuri Sh. pa menduar dhe pa ditur për ndonjë pasojë eventuale por edhe duke menduar se me bindje të plotë po e kryente një shërbim të lejueshëm, e kishte telefonuar punëtorin e vet S.E., duke i kërkuar qe shumë e parave përmes llogarisë bankare ta transferoj të subjekti i lartcekur, për këtë i pandehuri asnjëherë nuk kishte kuptuar e as dyshuar se në transferim të parave kishte diçka të palejuar apo kundërligjshme dhe derisa është marrë në pyetje nga policia hetimore nuk kishte dëgjuar për termin shpërlarje e parave dhe nuk kishte njohuri se si mund të kryhej kjo vepër. Po ashtu mbrojtja ka vlerësuar se kjo ishte shumë normale sepse në vitin 2004 ishte nxjerrë Rregullorja e UNMIK për pengimin e pastrimit të parave, ku jo vetëm i pandehuri Sh. por edhe shumë kush nuk e ka ditur për këtë rregullore, duke shtuar se për atë transferim parash H. nuk i ka ofruar ndonjë shpërblim e as Sh. nuk i ka shku mendja më kërku nga ai ndonjë shpërblim. Po ashtu, mbrojtja ka sqaruar se çka nënkupton shpërlarja e parave duke iu referuar Doracakut të IGJK për trajnim i datës 22.09.2004, ku theksohet se cilat para mund të pastrohen e ndër to janë paratë që vijnë nga aksionet terroriste, nga shitblerja e armëve, shitblerja e makinave të vjedhura dhe shitblerja e narkotikëve, pastaj i është referuar edhe Komentarit të KPRK-së të vitit 2012, në faqen 854 pos këtyre iu shtohet edhe burimi i parave të cilat vijnë nga kontrabandimi me migrantë dhe lojëra të fatit, duke shtuar se atëherë kur të pandehurit e kanë kryer këtë vepër në vitin 2005 nuk flitej për atë se këto para mund të vijnë nga lojërat e fatit apo kontrabandimi me migrantë. Andaj, mbrojtja ka vlerësuar se për të pandehurin Sh.R. mund të ketë vetëm veprime inkriminuese të ndihmës në kryerjen e veprës penale Shmangie nga tatimi dhe se edhe po të ekzistonte cilado nga tri format e veprës penale, provat e ekzaminuara në shqyrtim gjyqësor e kishin vërtetuar faktin se i pandehuri Sh.R. nuk kishte dashje në kryerjen e asaj vepre por ato prova e vërtetuan faktin se i pandehuri në fjalë ishte në lajthim të thellë juridik konform të dispozitave të nenit 19 paragrafi 1 të KPPK. Në fund të fjalës së tij përfundimtare i ka propozuar që në këtë rast ti aplikoj edhe dispozitat e nenit 3 – parimi in dubio pro reo të KPP, duke kërkuar atë se në mungesë të provave për vërtetimin e veprës penale besimi ti falet mbrojtjes së të pandehurit.

Në fjalën përfundimtare, i akuzuari Sh.R. ka deklaruar se e përkrahë fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe nuk kam çfarë të shtoj.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, janë administruar provat materiale të propozuara nga prokuroria në aktakuzë, e të paraqitura si në vijim:

Prokurori special ka theksuar se meqenëse lënda ka një volum të madh dhe me vendimin e Gjykatës Supreme çështja është kthyer në rigjykim vetëm për veprat penale shpëlarja e parasë për të akuzuarin H.Y. dhe ndihma në shpëlarjen e parasë për të akuzuarin Sh.R., si prova materiale për këta dy të akuzuar do të paraqes provat si në vijim:

- Ekspertiza financiare e datës 19.03.2008 e përpiluar nga eksperti R.B. për të akuzuarin S.U., etj;

- Ekspertiza financiare e datës 24.12.2008 e përpiluar nga eksperti R.B. për të akuzuarin S.U., H.Y., B.K., E.Gj., Sh.M. dhe Sh.R., e nga të cilat prova rezulton se aty janë llogaritë bankare të dy firmave "E..." që e ka përfaqësuar i akuzuari Sh.R. si menaxher dhe firma "K...", pjesë e së cilës ka qenë tani i akuzuari H.Y. si arkëtar i asaj firme dhe fuqinë provuese të këtyre provave do ta elaboroj gjatë shqyrtimit gjyqësor ose në fjalën përfundimtare.

Mbrojtësi i të akuzuarit H.Y., av. Ali Beka ka thënë se në kuptim të mbrojtjes ka vërejtje në provat e paraqitura nga prokurori, e të cilat do t'i paraqes gjatë shqyrtimit gjyqësor ose në fjalë përfundimtare, për faktin se me aktakuzën bazë, të gjitha provat e propozuara si personale edhe ato materiale kryesisht kanë qenë për veprat penale për të cilat veç është marrë një epilog përfundimtar nga gjykata, ndërsa në raport me veprën penale për të cilën tani akuzohen H.Y. dhe Sh.R., ekspertiza e parë fare nuk ka të bëjë me veprën penale për të cilën janë akuzuar të pandehurit në sallë, ndërsa ekspertiza e dytë nuk ka qenë e propozuar për ekspertim fare nga prokuroria por nga mbrojtësit e për të cilën ekspertizë qysh edhe në gjykimin e parë i kanë paraqitur vërejtjet dhe komentet e tyre.

I akuzuari H.Y. ka mbështetur vërejtjet e mbrojtësit të tij në provat e paraqitura nga prokurori.

Edhe mbrojtësi i të pandehurit Sh.R., av. Abdylaziz Sadiku ka thënë se i akcepton vërejtjet e kolegut të tij Beka.

Edhe i akuzuari Sh.R. ka mbështetur vërejtjet e mbrojtësit të tij.

Pasi është njoftuar me të drejtat e tij, në bazë të nenit 344 të KPP, se ka të drejtë të mos deklarohet, e nëse zgjedh të deklarohet marrja e tij në pyetje do të zbatohet në pajtim me paragrafët 2 dhe 4 të këtij neni, i akuzuari H.Y. ka thënë se do ta shfrytëzoi të drejtën e tij për të deklaruar dhe në pyetje nga mbrojtësi i tij, i akuzuari H.Y. është përgjigjur se si e kishte kryer gjimnazin dhe së pari kishte filluar të punoj në Turqi në vitin 1998, si arkëtar në firmën "K..." në Stamboll, ndërsa në Kosovë kishte ardhur në dhjetor të vitit 2004 me të njëjtën firmë dhe kishte punuar të njëjtën punë – arkëtar, duke shtuar se Kompania "K...", në Kosovë ka pasur Kompaninë e Sigurimeve "K...e" dhe Kompaninë "K2...", e në të njëjtën kompani ishte edhe "K1...", në të cilën ai ka punuar si arkëtar dhe ka kryer blerjet- furnizimin e mallrave të kuzhinës që kanë përfshirë perimet dhe pijet për restorantin në "K1..." duke theksuar se edhe kontratën e punës në "K..." e ka pasur si arkëtar dhe nuk kishte pasur përshkrim tjetër të punëve, por se disa



nga detyrat e tij të punës ishin kryerja e pagesës së pagave të punëtorëve në “K1...” si dhe blerjet – furnizimi për restorantin. Po ashtu, i akuzuari Y. ka thënë se lista e pagave të punëtorëve ishte e përpiluar nga zyrtarë tjerë të firmës - menaxheri, ndërsa ai-H. kishte kryer vetëm pagesat në bankë por ka pasur raste që punëtorëve t’iu ketë dhënë ndonjë shumë të pagës si avans para përfundimit të muajit, përkatësisht nëse dikush e kishte pasur pagën 300 euro ai i kishte dhënë më herët 100 euro me kërkesën e punëtorit. Pastaj ka thënë se pazarin ditor të “K1...” e mbanin edhe në para të gatshme por e dorëzonin edhe në bankë, duke vepruar ashtu siç e urdhëronte menaxheri, pasi që kazinoja punonte natën, ndërsa i akuzuari H. shkonte në punë në mëngjes dhe nëse kishte pasur ndonjë urdhër për kryerjen e pagesave nga menaxheri, ai i kryente, duke theksuar se ka pranuar urdhra edhe nga menaxherët e firmës të cilët ishin në Stamboll dhe në Elbasan, ashtu siç e kishin urdhëruar ata, ai kishte vepruar, e gjatë punës së tij kishte raste të kishte kryer pagesa ose deponime për persona ose firma të tjera pasi e kishte urdhëruar kompania “K...”, duke përfshirë K. – menaxheri i firmës “K1...” në Elbasan. Pastaj, i akuzuari Y. ka thënë se e njeh të akuzuarin Sh.R., pasi që i njëjti ishte marrë me skrap - metale e i cili kishte pasur firmën në Ferizaj dhe nuk kishte pasur bashkëpunim me të, por te i njëjti kishte deponuar një shumë prej 99.000 dollarë, pasi që atë - H. e kishte thirrur K. dhe i kishte thënë që 99.000 dollarë t’ia jepte Sh., por nuk i kishte dhënë arsye se përse duhej ta bënte atë pagesë dhe se ai nuk kishte pranuar asnjë pagesë ekstra në punë për këtë pagesë të kryer Sh., duke theksuar se ai ishte vetëm arkëtar dhe nuk kishte pasur kompetence të kryej punë të tjera pa urdhrat e menaxherëve të kompanisë, ashtu siç e kishin urdhëruar ata ai kishte vepruar duke shtuar se nuk kishte pasur njohuri nëse deponimi i mjeteve prej 99.000 dollarë ka qenë i jashtëligjshëm apo i ligjshëm dhe se për të ishte njësoj sikur 100 dollarë kur ia kishte dhënë një punëtor avans për pagën sikur 99.000 dollarë kur ia kishte deponuar Sh., e po ta kishte ditur se deponimi i 99.000 dollarëve Sh. ishte i kundërligjshëm nuk do ta kishte kryer atë, do ta kishte lënë punën dhe do të ishte larguar nga Kosova. Po ashtu, i akuzuari Y. ka thënë se aq sa i kujtohej, në Kompaninë “K...” kishte punuar deri në vitin 2011, pastaj ishte kthyer në Turqi ku kishte punuar tri vite në një firmë për lifta – ashensorë e pastaj kishte hapur firmën e tij për lifta, përkatësisht përgatit materialin për një lift, e futë në paketë dhe e qon te porositesit, të cilën janë nga gjithë bota por ka edhe katër firma nga Kosova, me të cilat punon që nga viti 2019, duke shtuar se nuk ka pasur autorizim të kryente pagesa nga xhirollogaria e “K...” në interes të personave apo firmave të tjera dhe se ishte e vërtetë se shumë prej 99.000 dollarë ai në fillim e kishte deponuar në llogarinë e tij personale në bankë, pastaj nga llogaria e tij i kishte transferuar në llogarinë bankare të Sh.R., por tani nuk i kujtohej nëse mjetet prej 99.000 dollarë një ditë pas deponimit në llogarinë e tij, t’i ketë tërhequr të nesërmen në dy këste, njëra 68.485 dhe tjetra 30.999 dollarë, në shumë të përgjithshme prej 99.484 dollarë, por me sa i kujtohej, këto para i kishte deponuar në fillim në xhirollogarinë e tij personale për t’ia transferuar Sh. ashtu siç i kishte thënë K.Z., duke theksuar se nuk e ka ditur nëse mjetet - paratë si më lart kanë qenë të pazarit ditor të “K1...” dhe nuk ishte i sigurt nëse shumë prej 99.000 dollarë e kishte deponuar ai në xhirollogarinë e vet apo dikush tjetër, por e di se K. i kishte thënë që këto para t’ia transferonte Sh., pa e ditur arsyen pse kishte bërë dy tërheqje të kësaj shume, duke shtuar se Sh. atë ditë e kishte thirrur me telefon, e i njëjti i kishte thënë se gjendej në Maqedoni dhe i kishte thënë që paratë t’ia transferonte në xhirollogarinë e tij të cilën ia kishte thënë përmes telefonit, ndërsa ky- H. e kishte shkruajtur xhirollogarinë dhe ia kishte transferuar paratë, duke menduar se kjo mënyrë e transferimit të parave Sh. ishte për shkak se ai nuk kishte pasur autorizime në xhirollogarinë e firmës “K...”, por me sa i kujtohej këto para prej 99.000 dollarëve kishin ardhur nga jashtë Kosovës pasi gjatë punës së tij kishte punuar me euro dhe ka mundësi që 99.000 dollarë kanë ardhur nga Stambolli për pagesë të Sh., ose ndoshta për hekurishtet e blera nga Sh.

Në pyetje nga mbrojtësi i të akuzuarit Sh.R., i akuzuari H.Y. është përgjigjur se ai nuk kishte pasur njohuri nëse transferi i këtyre parave Sh.ut ishte dashur të tatimohet, duke theksuar se po të kishte vërejtur diçka që është e ndaluar me ligj nuk do të kishte vepruar.

Ndërsa në pyetje të KTGJ, i akuzuari H.Y. është përgjigjur se ai nuk kishte pasur autorizim dhe kompetencë të paguante tatimet e firmës në Kosovë, pasi për këtë ishte menaxheri për të cilin ka thënë se nëse nuk gabon e ka pasur emrin M., i cili ishte shqiptarë dhe ishte marrë me kontabilitetin e firmës, duke shtuar se në firmën “K...” ka punuar edhe babai i tij, si mjeshtër saldues në Elbasan në fabrikën e hekurit dhe se ai - H. dhe babai i tij në firmën “K...” kishin qenë vetëm punëtorë, ndërsa në kohën kur e kishte kryer transferin e parave te Sh., ai e kishte ditur se ai i shiste hekurishte firmës “K...” por për ta kryer pagesën e kishte urdhëruar K., i cili ishte menaxher i “K...” në Elbasan, derisa në Kosovë i kishte pasur menaxherë B.K. dhe E.Gj., duke theksuar se ai nuk kishte pasur aq kompetencë që ta kundërshtonte urdhrin e K. për transferin e parave Sh. Në fund të mbrojtjes së tij, i akuzuari H.Y. ka thënë se nuk i nevojitet përkthyesi, me arsyetim “siç e patë edhe ju, e di mirë gjuhën shqipe”.

Edhe i akuzuari Sh.R., pasi është njoftuar me të drejtat e tij, ka thënë se do ta shfrytëzoi të drejtën e tij për të deklaruar dhe në pyetje nga mbrojtësi i tij është përgjigjur se ka qenë dhe është menaxher i firmës “E...”, e regjistruar në Viti, por që veprimtarinë e ka në Ferizaj, e cila nga viti 2002 është marrë me hekur ndërtimi, hekurishte-skrap, përkatësisht me grumbullimin e hekurishteve-llamarinave, hekurit të papërdorshëm e pastaj të njëjtat i ka dërguar për shitje në fabrikën e çelikut “K...” në Elbasan- Shqipëri, ndërsa tani merret edhe me ndërtim, duke shtuar se në Fabrikën e hekurit “K...” në Elbasan ka filluar të dërgoj hekurishte që nga viti 2001-2002 ndërsa pagesat “K...” ua ka kryer përmes bankës, por ka pasur raste edhe në para të gatshme. Pastaj, i akuzuari R. ka thënë se me “K...” kanë pasur bashkëpunim të mirë, kanë komunikuar me menaxherin K., ndërsa përmes tij e ka njohur tani të akuzuarin H.Y., duke shtuar se sa i përket shumës prej 99.000 dollarë, atë e kishte thirrur K. nga Elbasani dhe i kishte thënë “H. t’i sjellë 99.000 dollarë dhe t’i do të mi sjellësh në Shqipëri”, pa ia treguar arsyetimin, e derisa ai në atë moment ndodhej në Maqedoni duke shkuar në Shqipëri, i kishte thënë punëtorit të tij, S.E. që ta kryej transferin e parave në shumën 99.000 për “K.” në Shqipëri pa e ditur se po bëhet ndonjë shpëlarje e parasë apo diçka tjetër, e këtë veprim e kishte kryer në besim dhe po ta kishte ditur se në këtë rast ka diçka të kundërligjshme, ai nuk do të kishte lejuar të kryhej ky transfer, duke theksuar se krejt kjo ishte bërë prej mosdijes dhe jashtë kontrollit gjatë kryerjes së pagesave, pasi në atë kohë brenda vitit kishin pasur pagesa prej 10-15 milion euro qarkullim dhe se për këtë transfer të kryer drejt “K.” në Shqipëri ai nuk kishte pasur asnjë interes e as që kishte përfituar diçka dhe meqenëse këto para kishin kaluar përmes xhironlogarisë së tij – Sh., beson se tatimi për to ishte paguar. Po ashtu, i akuzuari R. ka thënë se gjatë bashkëpunimit me K., i njëjti ka qenë korrekt me firmën e tij dhe po të mos i kishte thënë K. ai nuk do t’i kishte transferuar ato para te “K.” Elbasan, duke shtuar se në atë kohë ai nuk kishte ditur për termin shpëlarje e parasë, dhe se kjo punë përbënte shpëlarje parash kishte kuptuar në vitin 2005 nga hetuesit, duke theksuar se që nga transferi i këtyre parave në “K.” e deri në marrjen në pyetje në polici, ai ka pasur mundësi që këtë transfer ta rregulloj me letra, pasi që gjatë punës, bankat më të cilat kishte bashkëpunuar kishin kërkuar rritjen e overdraftit, e atyre iu kishte konvnuar ky transfer përmes bankës sepse mbi këtë bazë kishin marrë edhe kredi dhe kishin rritur shumën e overdraftit.

Në pyetje nga prokurori special, i akuzuari Sh.R. ka deklaruar se paratë të cilat ia kishin transferuar në “K...” Elbasan, H. i kishte dorëzuar në llogarinë e “E...” në cash – para të gatshme, e pastaj ai i kishte thënë punëtorit të tij, i cili ia kishte transferuar në “K...” dhe po ta kishte ditur se vjen gjendja kështu ai ka mundur të thotë se paratë i ka transferuar drejtpërdrejtë nga firma e tij pa e përmendur të akuzuarin H., i cili në emër të tij, në prani të punëtorit të tij S.E., kishte deponuar 99.000 dollarë në llogarinë “E...”, pastaj S.sipas urdhrit të tij – tani të akuzuarit R., i kishte transferuar në “K...” Elbasan, me arsyetim “për hekur”, duke theksuar se me transferin e këtyre mjeteve e kishte ndihmuar K.n, pasi me të kishin pasur bashkëpunim afarist dhe se ai ka mundur që këtë shumë prej 99.000 dollarë ta arsyetoj me fatura, blerje, me hekur ndërtimi-armaturë, si dhe ka pohuar se shuma prej 99.000 dollarë ka hyrë në librat e kontabilitetit te “E...”.

Aktgjykimi si më lart është bazuar vetëm në faktet dhe provat e proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor, siç parasheh dispozita e nenit 360 të KPP, e për të cilat do të jepet vlerësimi si në vijim:

Nga ekspertizat financiare të datave 19.03.2008 dhe 24.12.2008, të përpiluara nga eksperti R.B., për të akuzuarit Y. dhe R. është konstatuar se këto mjete nuk figurojnë në librat zyrtare të biznesit E..., përkatësisht asnjëherë nuk janë zyrtarizuar.

Nga mbrojtja e të akuzuarit H.Y. është vërtetuar se i njëjti në Kosovë kishte ardhur në dhjetor të vitit 2004 nga Kompania "K...", në Turqi, e cila në Kosovë ka pasur Kompaninë e Sigurimeve "K.1..." dhe Kompaninë "K.2...", e në të njëjtën kompani ka qenë edhe "K1...", në të cilën ai ka punuar si arkëtar, e në këtë cilësi ka kryer pagesat e pagave të punëtorëve në "K1..." si dhe blerjet – furnizimet për restorantin dhe se gjatë punës së tij pazarin ditor të "K1..." e mbante edhe në para të gatshme por e dorëzonte edhe në bankë, duke vepruar ashtu siç e ka urdhëruar K. – menaxheri i firmës "K.1..." në Elbasan. Po ashtu, sipas të akuzuarit Y., për t'i deponuar 99.000 dollarë të "E..." e kishte urdhëruar menaxheri K., i cili i kishte thënë të akuzuarit Y. që 99.000 dollarë t'ia jepte Sh., pa i dhënë arsye se përse duhej ta bënte atë pagesë dhe se i njëjti nuk kishte pasur kompetenca të kryej punë të tjera pa urdhrat e menaxherëve të kompanisë, përkatësisht ashtu siç e kishin urdhëruar ata, ai kishte vepruar, pa e ditur se deponimi i mjeteve prej 99.000 dollarë ka qenë i jashtëligjshëm apo i ligjshëm, e po ashtu ai nuk kishte pasur aq kompetencë që ta kundërshtonte urdhrin e K. për transferin e parave Sh.

Nga mbrojtja e të akuzuarit Sh.R. është vërtetuar se ka qenë dhe është menaxher i firmës "E...", e cila nga viti 2002 është marrë me grumbullimin e hekurishteve- llamarinave, hekurit të përdorshëm të cilat i ka dërguar për shitje në fabrikën e çelikut "K." në Elbasan- Shqipëri, me të cilën kanë pasur bashkëpunim të mirë dhe ka komunikuar me menaxherin K., përmes të cilit e ka njohur tani të akuzuarin H.Y., i cili pasi e kishte urdhëruar K., ia kishte dërguar shumën prej 99.000 dollarë, e pastaj ky – i akuzuari R. meqë ndodhej në Maqedoni e kishte thirrur dhe i kishte thënë punëtorit të tij, S.E. që ta kryej transferin e parave në shumën 99.000 për "K." në Shqipëri pa e ditur se po bëhet ndonjë shpëlarje e parasë apo diçka tjetër.

Pas këshillimit dhe votimit, trupi gjykues ka ardhur në përfundimin që ndaj të akuzuarve H.Y. dhe Sh.R., për veprat penale për të cilat akuzohen, të merret aktgjykim lirues pasi që nuk është provuar se kanë kryer veprat penale, përkatësisht në rastin konkret, me asnjë provë nuk është provuar se të hollat në shumë prej 99 mijë dollarë, të cilat kanë qenë objekt transferi, të kenë buruar nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal, e që sipas rregullores si më lart është elementi kryesor i veprës penale të pastrimit të parave, përkatësisht paratë si me lart kanë qenë të përfituara nga subjekti "K...", i regjistruar si biznes, i cili ka afaruar si biznes, ka paguar tatimet në ATK dhe aktiviteti i saj ka qenë i ligjshëm. Në rastin konkret, roli i të akuzuarit H. ka qenë zbatimi i urdhrin nga eprori i tij, dhe në cilësi të arkatarit i ka përmbushur detyrat e punës, ka hapur xhirollogari në bankë, ka transferuar para të tani i akuzuari Sh.R., i cili si bashkëpunëtor i firmës "K.1...", paratë si me lart i ka transferuar në atë firmë, me të cilin kishte bashkëpunim të vazhdueshëm në shitjen e hekurishteve të vjetra dhe se veprimet e tyre kanë të bëjnë vetëm me zhvillimin e ekonomisë së tregut të lirë e cila ekonomi promovohet edhe në demokracitë edhe me të zhvilluara në botë. Andaj, në rastin konkret me asnjë provë nuk është vërtetuar se paratë e transferuara nga dy të akuzuarit kanë buruar nga aktiviteti kriminal, si kusht bazë për të vazhduar me dispozitat e nenit 10, par. 10.2, pika a, b dhe d, të Rregullores së UNMIK numër 2004/2, mbi pengimin e pastrimit të parave dhe veprave të ngjashme penale.

Po ashtu në rastin konkret, trupi gjykues ka ardhur në perfundimin se me asnjë provë formale e as materiale nuk është vërtetuar se tani të akuzuarit Y. dhe R. e kanë ditur apo kanë pasur arsye që ta dinë se pasuria, përkatësisht shuma e parave prej 99.000 dollarë ka buruar nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal, përkatësisht është përfituar me vepër penale sepse të akuzuarit njëri në cilësinë e arkëtarit të kompanisë “K...”, e tjetri si pronar i Kompanisë “E...”, të regjistruara si biznese, të cilat kanë afaruar si biznese, kanë paguar tatimet në ATK dhe aktiviteti i tyre ka qenë i ligjshëm, përkatësisht në aktakuzën e ngritur në pikën I të saj për të cilën të akuzuarit: S.U., E.Gj., B.K. dhe H.Y. janë shpallur fajtor për veprën penale shmangie nga tatimi për biznesin “K...”, pasi në ATK kishin paraqitur të dhëna të pavërteta për qarkullimin përkatësisht për fitimet e realizuara nga ky biznes.

Trupi gjykues ka vlerësuar edhe mbrojtjen e të akuzuarve, pasi që i akuzuari Y. kur ka deponuar shumën prej 99.000 dollarë të Kompania “E...”, ka zbatuar urdhrin e menaxherit të tij pasi ai ka qenë vetëm arkëtar dhe nuk ka pasur kompetencë që të vendos nëse këto para duhet të transferohen ose të mos transferohen te Kompania “E...”, e po ashtu edhe nga mbrojtja e të akuzuarit R. është vërtetuar se i njëjti vetëm se ka transferuar këto para te “K.1...” në Elbasan në emër të bashkëpunimit të tyre se lidhur me shitblerjen e hekurishteve të vjetra pa e ditur se po kryente ndonjë veprim të kundërligjshëm, marrë parasysh faktin se edhe rregullorja numër 2004/2 ishte përpiluar me 5 shkurt 2004, përkatësisht disa muaj para se të akuzuarit si me lart të kryenin transferin e shumës se mjeteve prej 99.000 dollarë.

Edhe prokurori i çështjes në fund të pikës III të aktakuzës ka theksuar se paratë e pastruara kanë rrjedhur si pasojë e veprimeve kriminale të veprave penale të mashtrimit dhe shmangies nga tatimi, pa arsyetuar se tani të akuzuarit e kanë ditur apo kanë pasur arsye ta dinë se paratë si me lart kanë buruar nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal, sepse gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se asnjëri nga të akuzuarit nuk e ka ditur se këto para kanë buruar nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal.

Trupi gjykues ka vlerësuar se aktakuza në pikën III, e ngritur kundër të pandehurve Y. dhe R., nuk është e bazuar pasi që prokuroria ka dështuar të paraqes prova të mjaftueshme për ta vërtetuar fajësinë e tyre, përkatësisht aktakuza është bazuar në një përshkrim të gjerë dhe të pa qartë, pa e arsyetuar fare faktin nëse të akuzuarit kanë ditur apo kanë pasur arsye ta dinë se paratë si me lart kanë buruar nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal, si element bazë për ndjekje penale ndaj tyre.

Bazuar në nenin 3 par. 2 të KPP, mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose zbatimin e dispozitave të ligjit penal, janë interpretuar në favor të të akuzuarve dhe të drejtave të tyre, sipas këtij kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe në pajtim me nenin 363 par. 3 të KPRK, gjykata ka marrë aktgjykim për lirues për të akuzuarit Y. dhe R., sepse nuk është provuar se të njëjtit kanë kryer veprat penale me të cilat janë ngarkuar nga prokuroria.

Në këtë rast, gjykata është bazuar edhe në nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, për një proces të hapur dhe të rregullt, që çdo person i akuzuar ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, duke pasur parasysh edhe bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij, si dhe në parimin që çdo person i akuzuar për një vepër penale të prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

Vendimi për shpenzimet procedurale u mor në bazë të nenit 454, par. 1 të KPP.

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të neneve 363, par. 1, nënpar. 1.3 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ky aktgjykim është përpiluar me datë 02.05.2024.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA  
PKR.nr.674/2012, datë 22.04.2024.

Bashkëpunëtoreshë profesionale,  
Arbenita Hoxha Koleci

Kryetari i trupit gjykues,  
Naser Foniqi

**UDHËZIMI PËR MJETET JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar **brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh**, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.